

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/nis-beteja-ne-apel-per-kater-ish-kreret-e-uck-se/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:10:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 21:29:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	553bc92193acedcc1db73c0bbb41624c6bf379a7b9813104aedcafd52c1b471
TEKSTI	d96af060bb18036b4091d76e4aae296d823c5b03978dbd0f3cbaa130209b7d2f
PAMJA	05185e924e612f5d71742ad098495a708604e13481d6bb37e7cdaf029ff85621

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	beb73cef396762aa32d28958f7eed47b54130012353499eba942163fc720f619
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/beb73cef396762aa32d28958f7eed47b54130012353499eba942163fc720f619>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së

by Sport Sport — September 22, 2026 in Aktualitet, Kosovë, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Pas dënimit në shkallën e parë, ka nisur zyrtarisht beteja ligjore në Apel për katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, të cilët javën e kaluar u dënuan me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte.

Ekipet e mbrojtjes kanë nisur këtë javë procedurat për njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës për apelin e vendimit.

Mbrojtja ka afat deri të premtën, më 25 shtator, për të njoftuar gjykatën se cilat pjesë të verdiktit do të kundërshtohen.

Thaçi dhe Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet, ndërsa Selimi me 13 vjet burgim.

Mbrojtja ka bërë të ditur se verdikti përmban disa pika që do të kundërshtohen në Apel, veçanërisht ato që lidhen me përgjegjësinë për vrasjet dhe ndalimet e paligjshme, në rrethana kur ndërhyr një palë e tretë, në këtë rast NATO.

Ndërkohë, avokati i viktimave ka afat deri më 14 tetor për të paraqitur prova lidhur me dëmtypërlimet, ndërsa Prokuroria ka afat deri më 4 nëntor për të dorëzuar shkresat e saj.

Amer Alija nga Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili monitoron gjykimet për krime lufte, ka thënë për Radio Kosovën se procesi i apelit përfshin disa etapa dhe pritet të zgjasë disa muaj, nga dorëzimi i njoftimit për ankimim deri te vendimi përfundimtar.

Sipas tij, rregullorja e procedurës dhe provave parasheh disa afate për njoftimet, përgjigjet ndaj ankesave, paraqitjen e ankesave dhe caktimin e seancës në gjykatën e shkallës së dytë.

Ndërkohë, në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar në Kuvend një projekt-nismë për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, duke thënë se synon më shumë llogaridhënie dhe transparencë të kësaj gjykate, e cila është e zhvendosur në Holandë.

TË FUNDIT

Tifozi i Manchester United është bërë i famshëm, Haaland i bën komentin epik: Priti flokët, shoku!

SEPTEMBER 22, 2026

Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i "Pascucci"; ortakut Ergys Agasit te "Dinamo" dhe pjesë e grupit të tij kriminal

SEPTEMBER 22, 2026

Nis beteja në Apel për katër ish-krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti i Federatës Gjermane sulmon Infantinon: Një manovër e qartë për të qëndruar në pushtet

SEPTEMBER 22, 2026

BE zgjat sanksionet ndaj Rusisë me 3 vjet

SEPTEMBER 22, 2026

"Nesër më shumë!" - Përfundon protesta e 115-të antiqeveritare, qytetarët të vendosur në qëllimin e tyre: Edi Rama, dorëhiqu!

SEPTEMBER 22, 2026

"Zbatim më i fortë i ligjit" - Mesazhi i ambasadës amerikane: Kur SHBA dhe Shqipëria qëndrojnë së bashku, komunitetet tona janë më të sigurta

SEPTEMBER 22, 2026

Protesta/ Arben Kola: Vlora Hyseni, na e fëlliqe emrin e qytetit! E ke kthyer SHISH-in në fole të UDB-së!

SEPTEMBER 22, 2026

Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit nga drejtimi i SHISH

SEPTEMBER 22, 2026

Aksident në Lezhë, vdes 50-vjeçari

SEPTEMBER 22, 2026

Previous Post

Presidenti i Federatës Gjermane sulmon Infantinon: Një manovër e qartë për të qëndruar në pushtet

Next Post

Si po i shpëton hetimit të SPAK Adrian Bardhi i "Pascucci"; ortakut Ergys Agasit te "Dinamo" dhe pjesë e grupit të tij kriminal



Sport Sport

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencë dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja
mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek/ Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.